

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: VEPRIM PËR KLIMËN

Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektet e tyre.

Target: 13.1

Të forcohen aftësitë ripërtëritëse dhe përshtatëse ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

PNDKP

Article 6.1

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

E drejta e jetës, të shtetësisë, të lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta.

DUDNJ

Neni 3

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

KDF

Neni 6.1

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

KDF

Neni 6.2

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 37.c

KDF

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerezore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;

(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

KDF

Konventa për të
Drejtat e Fëmijës

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në intresin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

(d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Ligjet

Nenet

LMFNFT

Ligji Nr. 04/-L-027 PËR

MBROJTJE NGA

FATKEQËSITË

NATYRORE DHE

FATKEQËSITË

TJERA, GAZETA

ZYRTARE E

REPUBLIKËS SË

KOSOVËS / Nr. 22 /

Neni 1

Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 2

LMFNFT

Ligji Nr. 04/-L-027 PËR

MBROJTJE NGA

FATKEQËSITË

NATYRORE DHE

FATKEQËSITË

TJERA, GAZETA

ZYRTARE E

REPUBLIKËS SË

KOSOVËS / Nr. 22 /

Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i këtij ligji është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë e tilla. 2. Shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si sistem unik dhe integral shtetëror. 3. Sistemi i mbrojtjes nga paragrafi 2. i këtij neni përmban programimin, planifikimin, organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Ligjet

Nenet

Neni 4

Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

LMFNFT

Ligji Nr. 04/-L-027 PËR
MBROJTJE NGA
FATKEQËSITË
NATYRORE DHE
FATKEQËSITË
TJERA, GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 22 /

1. Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë: 1.1. zbulimi, monitorimi dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; 1.2. parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera; 1.3. njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; 1.4. trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës; 1.5. organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; 1.6. vetëmbrojtja, vetë ndihma dhe ndihma reciproke; 1.7. mobilizimi dhe aktivizimi i mekanizmave për mbrojtje dhe shpëtim dhe Strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; 1.8. përcaktimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse; 1.9. shpëtimi dhe ndihma; 1.10. rimëkëmbja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë; 1.11. vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; 1.12. bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; 1.13. mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; 1.14. dhënia e ndihmës për vendet tjera në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

LMFNFT

Ligji Nr. 04/-L-027 PËR
MBROJTJE NGA
FATKEQËSITË
NATYRORE DHE
FATKEQËSITË
TJERA, GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 22 /

Neni 5

Mbrojtja dhe Shpëtimi

1. Mbrojtja dhe shpëtimi organizohen si element integral i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave. 2. Mbrojtja, shpëtimi dhe aktivitetet tjera të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë të natyrës humanitare dhe jo ushtarake.

LMFNFT

Ligji Nr. 04/-L-027 PËR
MBROJTJE NGA
FATKEQËSITË
NATYRORE DHE
FATKEQËSITË
TJERA, GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 22 /

Neni 6

Njoftimi për rrezikun

Çdo person është i obliguar që ta njoftoj qendrën më të afërt emergjente ose policinë për çdo rrezik nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera sa më shpjet që e vëren apo kupton për të.